



STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 15 maj 2013

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) DREJTON MBI 20 MILIONE DOLLARE NE FONDE FEDERALE PER TE RIMBURSUAR VENDET PER KOSTOT E PASTRIMIT TE SUPER STUHISE SENDI (SANDY)**

Guvernatori Endrju M. Cuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar mbi 20 milionë dollarë për rajonet e prekura nga super stuhia Sendi (Sandy) për rimbursimin e kostove për pastrimin pas stuhisë. Vendet që do të marrin këto fonde të miratuara nga FEMA përfshijnë: Fshatin e Friport (Village of Freeport), Qarku Naso (Nassau County); Fshatin e Uestbëri (Village of Westbury), Qarku Naso (Nassau County); Qytezën e Oistër Bei (Town of Oyster Bay), Qarku Naso (Nassau County); Departamentin e Shëndetësisë të Qarkut Suffolk (Suffolk County Department of Health); Qarku Uestçestër (Westchester County); Qyteti i Jonkërs (City of Yonkers), Qarku Uestçestër (Westchester County); dhe Departamentin e Transportit të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Department of Transportation).

“Në çdo komunitet të prekur nga Sendi (Sandy), ishte thelbësore që të përgjigjeshim shpejt dhe të hiqim mbeturinat e lidhura me stuhinë që paraqitën një rrezik të menjëhershëm për shëndetin dhe sigurinë,” tha Guvernatori Cuomo (Cuomo). “Komunave anembanë Long Ajlënd (Long Island), Luginës së Poshtme të Hadsonit (Lower Hudson Valley) dhe rajonit metropolitan të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) iu desh të vepronin shpejt për të hequr mbeturinat e stuhisë dhe për të rimëkëmbur komunitetin e tyre sa më shpejt që të ishte e mundur. Jam i gëzuar të jem në gjendje që të drejtoj këto fonde përsëri tek këto vende për të rimbursuar kostot e tyre dhe për të ndihmuar në përpjekjet e vazhdueshme të rimëkëmbjes.”

“Rimëkëmbja e komuniteteve të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) është përparësia më e lartë e departamentit tonë dhe këto fonde të rimbursimit të Ndihmës Publike do të ndihmojnë secilin nga komunitetet e prekura që të rindërtojnë më shpejt dhe më të fortë,” tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commissioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t'i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

### **Fshati i Friport (Village of Freeport), Qarku Naso (Nassau County)**

Fshati i Friport (Village of Freeport), Qarku Naso (Nassau County), është duke marë 1,835,311 dollarë për rimbursimin e kostove të pësuar nga fshati pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Fshati i Friport (Village of Freeport) vuajti nga ujrat me rrëmbim të përmytjes, shirat dhe erërat e mëdha, që përmytën mbi 40 përqind të Fshatit, përfshirë mbi 4,000 shtëpi, biznese dhe mjedise të infrastrukturës së rëndësishme (p.sh. centrale, kanale kulluese, etj.), që u përmytën në një thellësi prej deri në 8 këmbë. Mbeturinat në pikat e kalimit u identifikuan pas valës së stuhisë dhe vërshimit në tokë të Sendit (Sandy). Mbeturinat e stuhisë që erdhën nga uji, të përbëra nga pemë, degë, orendi të dëmtuara nga uji dhe pajisje të mëdha elektroshtëpiake, automjete dhe mbeturina nga ndërtesat e dëmtuara ose të shkatërruara u përhapën anembanë Friport (Freeport), përfshirë 53,389 jardë kub të mbeturinave të përziera të ndërtimit, shkatërrimit dhe bimore. Në shumë zona, mbeturinat bllokuan pikat e hyrjes së urgjencës dhe krijuan një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, duke kërkuar që Fshati të reagojë me shpejtësi për largimin e këtij rreziku nga komunitetet kryesisht me banorë dhe nga shumë pika të kalimit. Fshati vlerësoi se 18.6 milje të kanaleve kulluese të përmytura më parë, 738 basene të grumbullimit dhe 365 puseta u deshën të pastrohen nga mbeturinat e stuhisë për të eliminuar rreziqet e përmytjes. Kostot përbëheshin nga puna e komunës, pajisje, material, pajisje të mara me qira dhe shërbime të kontraktuara.

### **Fshati i Uestbëri (Village of Westbury), Qarku Naso (Nassau County)**

Fshati i Uestbëri (Village of Westbury) Qarku Naso (Nassau County) është duke marë 463,603 dollarë për rimbursime të kostove të pësuar nga fshati pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Erëra e shira të fortë dhe pemë e degë të pemëve të dëmtuara nga Sendi (Sandy) shkaktuan një grumbullim të rreth 8,886 jardë kub të mbeturinave drurore në rrugë, trotuarë të kalimtarëve, vende të parkimit dhe prona të tjera. Fshati përdori punën e komunës, pajisje dhe material, si dhe kontraktorë privatë dhe Qarkun Naso (Nassau County) për të grumbulluar, hequr dhe eliminuar mbeturinat.

### **Qyteza e Oistër Bei (Town of Oyster Bay), Qarku Naso (Nassau County)**

Qyteza e Oistër Bei (Town of Oyster Bay), Qarku Naso (Nassau County), është duke marë 13,143,778 dollarë për kostot e pësuar nga qyteza pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Erëra të forta dhe shira të dendur krijuan përmytje mbi tokë dhe vërshime të stuhisë nga Sendi (Sandy), që rrëzuan pemë, degë të pemëve, shtylla të korrentit dhe shkatërruan mjediset kulluese të rrugëve dhe ndërtesave anembanë Qarkut Naso (Nassau County). Rrugët u bllokuan nga mbeturina e linja të rrëzuara të korrentit, duke shkaktuar kushte të rrezikshme anembanë rajonit. Stuhia përmyti zona të banimit dhe tregtare anembanë Oistër Bei (Oyster Bay) duke depozituar rreth 101,506 tonë të mbeturinave të ndërtimit dhe shkatërrimit. Qyteza përdori punën e komunës, pajisje dhe kontraktorë privatë për të reaguar ndaj emergjencës.

### **Departamenti i Shëndetësisë i Qarkut Suffolk (Suffolk County Department of Health)**

Departamenti i Shëndetësisë i Qarkut Suffolk (Suffolk County Department of Health) është duke marë 387,792 dollarë për rimbursimin e kostove të pësuar nga qarku pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Erëra të mëdha, shira të dendur dhe përmytje të lokalizuara nga Sendi (Sandy) krijuan një kërcënim të shëndetit publik për banorët e Qarkut Suffolk (Suffolk County). Kushtet e përmytjes

shkaktuan një kërcënim të menjëhershëm për jetën, shëndetin dhe sigurinë publike, duke përfshirë mungesa të korrentit, ndotjen e ujit, mungesën e shërbimeve të urgjencës dhe të mjediseve mjekësore të rëndësishme. Departamentit të Shëndetësisë të Suffolk (Suffolk Health Department) iu ngarkua detyra për të siguruar shërbime mbrojtëse urgjente për banorët e Qarkut Suffolk (Suffolk County), pasi vakcina dhe pajisje të tjera mjekësore u shkatërruan për shkak të mungesës së korrentit, e cila shkaktoi mungesën e ngrirjes në frigorifera. Grupet e posaçme të Mbrojtjes së Shëndetit Publik (Public Health Protection) u krijuan për të siguruar masat mbrojtëse anembanë Qarkut, si Njësitë e Kontrollit të Ushqimit (Food Control Units) për të parandaluar sëmundjet nga ushqimet, Njësitë e Shëndetshmërisë së Cilësisë së Mjedisit (Environmental Quality Health) dhanë ujë të pijshëm të sigurtë, trajtim të përshtatshëm të ujrave të zeza dhe eliminimin e mbeturinave toksike/të rrezikshme dhe Njësitë e Shëndetit Mendor dhe Higjenës (Mental Health and Hygiene) kryhen vaksinime dhe vlerësime të cilësisë së izolimit tek personeli.

### **Qarku Uestçestër (Westchester County)**

Qarku Uestçestër (Westchester County) është duke marë 1,920,095 dollarë për rimbursime të kostove të pësuaras pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Si një rezultat i drejtpërdrejtë i erërave të forta të vazhdueshme dhe rreshjeve, rreth 39,580 jardë kub të mbeturinave të rrezikshme bimore, përfshirë shumë pemë të mëdha të rrëzuara dhe trungje të shkullur me rrënjë dhe 6,300 jardë kub të mbeturinave të rrezikshme ranore, përfshirë rërë, pluhur dhe zhavor u depozituan në prona publike në dhe përgjatë rrugëve, parqeve dhe pikave të kalimit anembanë Qarkut. Përveç kësaj, 2,378 tonë të mbeturinave të përziera të katastrofës, të klasifikuara si Mbeturina të Ngurta të Komunës dhe 40,314 tonë të mbeturinave bimore të katastrofës, të klasifikuara si Mbeturina Organike të Kopshtit u morën nga Strukturat e Mjedisit e Departamentit të Mjedisit të Uestçestër (Westchester County Department of Environmental Facilities). Në mënyrë që të eliminohej rreziku i menjëhershëm ndaj sigurisë/shëndetit dhe pronës publike, puna urgjente nga Qarku ishte e nevojshme për të hequr rreziqet e paraqitura nga të gjitha mbeturinat. Qarkut Uestçestër (Westchester County) përdori punën e komunës dhe burime të pajisjeve e kontraktorë privatë për të hequr mbeturinat.

### **Qyteti i Jonkërs (City of Yonkers), Qarku Uestçestër (Westchester County)**

Qyteti i Jonkërs (City of Yonkers), Qarku Uestçestër (Westchester County) është duke marë 1,649,816 dollarë për rimbursime të kostove të pësuaras pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Si një rezultat i drejtpërdrejtë i erërave të forta të vazhdueshme dhe rreshjeve, rreth 7,659 tonë të mbeturinave të rrezikshme bimore u depozituan në rrugë, parqe dhe pika të kalimit anembanë Qytetit. Në mënyrë që të eliminohej kërcënimet ndaj shëndetit dhe sigurisë publike, puna urgjente ishte e nevojshme për të hequr mbeturinat e rrezikshme bimore, përfshirë shumë pemë të mëdha të rrëzuara dhe shkurre. Qyteti përdori punën dhe pajisje të komunës, si dhe kontraktorë privatë për të hequr mbeturinat.

### **Departamenti i Transportit i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Department of Transportation)**

Departamenti i Transportit i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Department of Transportation) është duke marë 773,041 dollarë për rimbursime të kostove të pësuaras pas goditjes së super stuhisë Sendi (Sandy). Erëra të forta, shira të dëndur dhe vërshimi i stuhisë për shkak të uraganit Sendi (Sandy) shkaktuan dëme të gjëra anembanë Qytetit të Nju Jorkut (New York City), përfshirë grumbullimin e mbeturinave në rrugë, trotuarë dhe mjedise të tjera publike. Mbeturinat e përbëra nga materiale

drurore, rërë, gurë, mbeturina të rrugëve dhe ndërtesave/shtëpive e objekte të të gjitha llojeve të depozituara nga vërshimi i stuhisë dhe era penguan të drejtën e kalimit të automjeteve dhe paraqitën një kërcënim të menjëhershëm të shëndetit dhe sigurisë publike. NYC DOT punoi me Departamentin e Higjenës të Nju Jorkut (Department of Sanitation New York) (DSNY) në heqjen prej tyre të mbeturinave në të gjithë qytetin prej 1,300,000 jardë kub mbeturina. Ekipet gjithashtu ndihmuan Parqet dhe Argëtimin e NYC (NYC Parks and Recreation) në mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave nga parqet e Qytetit. Ekipet e DOT dhe Parqeve hoqën pemë dhe degë të rrëzuara si në autostrada të mëdha, ashtu edhe në rrjetin e rrugëve.

###

Lajme të tjera të disponueshme në [www.governor.ny.gov](http://www.governor.ny.gov)  
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | [press.office@exec.ny.gov](mailto:press.office@exec.ny.gov) | 518.474.8418